



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
QËNDRA KULTURORE  
"MARGARITA TUTULANI"

Berat, më 25 /05 /2019

Nr 77 .Prot.

**FTESË PËR NEGOCIATA**

Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" prane Bashkise Berat, mbështetur në vendimin nr.1173, datë 6.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", kërkon të realizojë projektin artistik "Spektakel Veror me Humor dhe Muzik".

Objekti i projektit është "Spektakel Veror me Humor dhe Muzik" organizuar nga Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" me qëllim organizimin e aktivitetit artistik, çlodhës dhe argëtues.

Fondi limit : 1 000 000 Leke me TVSH (një milion).

Burimi i financimit : Qendra Kulturore "Margarita Tutulani".

Operatori ekonomik duhet të paraqes pranë Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani":

- a. Ofertuesi të paraqesi ekstraktin e rregjistrimit ne QKB ose në rastin e OJF vendimin e Gjykatës për rregjistrimin se bashku me çertifikatën e rregjistrimit ne organin Tatimor (NIPT) në objektin e së cilit duhet të përfshihet organizimi i aktivitetit artistik, çlodhës dhe argëtues.
- b. nuk është në proces falimentimi, (status aktiv).
- c. nuk është dënuar për shkelje penale.
- d. nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.
- e. ka plotësuar detyrimet fiskale.
- f. ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,te lëshuar nga Administrata Tatimore.
- g. Përvoja të mëparëshme në organizimin e ngjarjeve.

- h. Projekti (të përmbajë: përshkrim të aktivitetit, kohezgjatjen e shfaqjes, informacion të detajuar lidhur me të gjitha performancat, emrat e performuesve, minutazhin për secilen performance).
- i. Çmimi i ofruar nga operatori së bashku me preventivin.

Kriteret për Pranim, duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës .

Te gjitha dokumentat duhet të jene origjinale ose kopje te noterizuar,

Jeni te lutur të paraqisni pranë :

Emri: Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani"

Adresa: Blvd. "Republika" , Berat

Dokumentacioni tuaj, duke marre parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin e dokumenteve ligjore, financiaro-ekonomike, teknike dhe formulari i kërkesës për pjesëmarrje është:**

**Data, ora, dhe adresa**

Data 03/06/2019 ora 12.00 Adresa : Blvd. "Republika", Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"

Gjuha (-et) për hartimin e ofertave është: Shqip

Jemi në pritje të dokumentave tuaj.

DREJTORE

Migera HOXHA

